



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.14/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Nënkryetaren e Gjykatës Nushe Kuka Mekaj, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.A, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J., me banim në lagjen “Q.” pn, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga I.H, nga J., ndaj gjyqtarit B.A, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 18.12.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë të Autoriteti Kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga I.H, nga J., me banim në lagjen “Q.” pn, ndaj gjyqtarit B.A, me arsyetimin se gjyqtari qe dhjetë vjet është i ngarkuar me lëndën C.nr.477/23 dhe i njëjti është armik i drejtësisë, i ligjit dhe Kushtetutës dhe i cili manipulohet nga i padituri A.K, të cilin gjyqtari e lejon që fizikisht dhe verbalisht ta sulmojë paditësin, këtu parashtruesin e ankesës I.Hn në seancë gjyqësore dhe ia lejon të njëjtit të lexoj shkrime patologjike, nënçmuese, diskriminuese, mizore dhe banale me qëllim që të nxitet reagimi fizik i paditësit, duke shtuar se ka kërkuar disa herë përjashtimin e gjyqtarit, por kërkesa i është refuzuar dhe se gjyqtari ende vazhdon të mbajë seanca në zyrë e jo në sallën e gjykimit ku afërsia mes palëve është 30 cm dhe nuk është prezent sigurimi i gjykatës, e kthen gjykimin në cirk duke ju nderuar vendet dhe duke e mbështetë të paditurin që t’a ofendojë, fyej dhe t’a kërcënoji fizikisht paditësin, i cili ka rrahë tavolinën dhe e ka sulmuar fizikisht në prani të gjyqtarit. Po ashtu, ka shtuar se gjyqtari i tjetëron deklaratat e tij, nuk ia pranon dhe nuk i konstaton në procesverbal kërcënimet dhe fyerjet e të paditurit. I njëjti po ashtu ka shtuar se gjyqtari B.A punon me njoftuesi dhe familjarizëm, e këshillon të paditurin ashtu që takohen para çdo seance koordinohen dhe bisedojnë bashkë se si ti bëjnë padrejtësi paditësit, këtu parashtruesit të ankesës, t’a ofendojnë, fyejnë, kërcënojnë dhe frikësojnë që të mos kërkoj kompensim të dëmit që i është shkaktuar nga i padituri, duke shtuar se ky gjyqtar është i korruptuar dhe punon për grupe politike duke anuar nga i padituri për shkak të trysnisë politike dhe interesit të bashkëshortes së gjyqtarit e cila punon në QKMF në D. dhe se te i njëjti gjyqtar e ka pas edhe lëndën për shkurorëzim me bashkëshorten me ç’rast i njëjti ka marrë të holla nga nëna e ish bashkëshortes që të mos i shkurorëzoj. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se i vetmi problem i tij është dëgjimi i dobët për çka fajtor është sulmi fizik nga i padituri andaj, ka kërkuar një gjyqtar të drejtë, profesionist dhe që flet qartë pasi gjyqtari A. me qëllim të abuzimit me lëndën e tij flet me zë të vogël që paditësi, këtu parashtruesi i ankesës të mos e dëgjoj qartë që të jep përgjigjen adekuate.

Me datë 18.12.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga I.H, ndaj gjyqtarit B.A.

Gjyqtari B.A, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit së ankesës ka deklaruar se pretendimi i parashtruesit të ankesës se lënda C.nr.477/2023, nuk është marrë në shqyrtim më shumë se 10 vite, është pretendim i pabazuar meqë në këtë çështje janë ndërmarrë një mori veprimesh nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, pasi këtu parashtruesi i ankesës disiplinore vetë ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe revizion në Gjykatën Supreme. Lidhur me pretendimin se i njëjti ka kërkuar përjashtimin e tij nga kjo lëndë më shumë se 11 herë, një pretendim i tillë është i pabazuar, i njëjti ka kërkuar përjashtimin me datë 02.12.2015, ku është vendosur me Aktvendimin C.nr.50/14, nga ish Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtim. Ankuesi përsëri me 20.07.2023 ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit dhe Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë e ka refuzuar pasi që për të njëjtën çështje është vendosur njëherë me aktvendimin e cekur më lartë. Ndërsa, lidhur me pretendimin se i padituri ka manipuluar me gjyqtarin dhe se koordinohen dhe bisedojnë me njëri - tjetrin, gjyqtari ka theksuar se pretendimet e tilla janë tendencioze, nuk kanë mbështetje ligjore as faktike sepse në punën e tij mbështetet në ligj dhe prova dhe konsideron se pretendimet e tilla më tepër kanë qëllim uljen e integritetit të tij personal dhe profesional, duke pretenduar që me akuza të padrejta dhe të pabaza do të arrij qëllimin e përjashtimit të tij si gjyqtar nga lënda. Lidhur me pretendimet e tjera, gjyqtari ka theksuar se me përgjegjësi penale, personale dhe materiale deklaroi se nuk ka asnjë mbështetje faktike e as ligjore dhe se qëllimi i vetëm i tij është përjashtimi i tij si gjyqtar nga lënda duke shtuar se gjatë gjykimit të kësaj çështje ka qenë i pavarur, i paanshëm dhe është bazuar vetëm në prova dhe fakte.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.A, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore nuk është e bazuar.

Autoriteti kompetent në vlerësim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës ka gjetur se ankuesi, të njëjtën ankesë disiplinore me disa ndryshime të vogla jo substanciale e ka parashtruar edhe me datë 02.11.2023 dhe e njëjta me Aktvendimin AD/GJTHPE/.nr.10/23, të datës 20.11.2023 i është refuzuar si e pabazuar, me arsyetim si në aktvendim. Pas pranimit të këtij aktvendimi, ankuesi ka përsëritur ankesën disiplinore dhe autoriteti kompetent edhe një herë me vëmendje ka vlerësuar pretendimet e parashtruesit të ankesës se lënda në të cilën parashtruesi i ankesës është palë paditëse ka zgjatur për dhjetë (10) vite, komunikon ex parte me të paditurin si dhe të njëjtin e këshillon dhe e ka mik mirëpo, ka gjetur se ashtu si në ankesën paraprake, pretendimet e tilla të ankuesit janë të paargumentuara dhe të pa mbështetura në asnjë provë të vetme. I njëjti, po ashtu me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e tij se gjyqtari është i ndikuar nga politika, ka marrë të holla nga persona të tretë e pretendimet e tjera të ngjashme andaj, deklaratimet e tilla si të vetme dhe të pa argumentuara me asnjë provë nga ana e parashtruesit të ankesës, nuk mund të merren për bazë për inicimin eventual të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.14/23, me datë 16.01.2024.

Nënkryetarja e Gjykatës

Nushe Kuka Mekaj

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.A*
- 3. Parashtruesit të ankesës – I.H, nga J.*